

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kryeparlamentari i Iranit: Epoka e përgjigjeve proporcionale ndaj sulmeve amerikane ka marrë fund - Sh qiptarja.com
ADRESA	https://shqiptarja.com/lajm/kryeparlamentari-i-iranit-epoka-e-pergjigjeve-proporcionale-ndaj-sulmeve-amerikane-ka-marre-fund
BURIMI	shqiptarja.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 14:34:59 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	6 shtator 2026, 13:26:03 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	661ca947c14e7cd399296551c45a78f7d330bf83f2395f3f963b99b7e498fb38
TEKSTI	deec8020435f458e6ac78dc50922d48ac352ef597bcac0ea29a0d8c42c4c6459
PAMJA	c54dfee9312972455b2dd30e7fd94bdf991898dce8b5e3a8f3a4cca0b5e8a43a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c356de4d2ebc1551a9349ae5761e53b1c78920db89dd342a1c00193564dfe140
E MËPARSHMJA	8858d79e85a43e36acd2e753e6ea8f7cf82c3551e825c7140d6240cd35b30873
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c356de4d2ebc1551a9349ae5761e53b1c78920db89dd342a1c00193564dfe140>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



A do ta sulmojë Amerika Iranin? Ish ambasadori në Report TV: Jemi më afër luftës, por diplomacia është shpresa e fundit!



Bota

Kryeparlamentari i Iranit: Epoka e përgjigjeve proporcionale ndaj sulmeve amerikane ka marrë fund

Komandanti i CENTCOM-it, Brad Cooper, paralajmëroi se sulmet e vazhdueshme iraniane ndaj anijeve amerikane do të përballen me kosto më të mëdha ekonomike dhe shkatërrimin e cisternave iraniane të naftës.



Mohammad Baqer Galibaf



Redaksia

6 Shtator, 15:23 | Përditësimi: 6 Shtator, 15:26

f Share Tweet



Kryetari i Parlamentit të Iranit, [Mohammad Baqer Galibaf](#), ka paralajmëruar se Irani do t'u përgjigjet më fuqishëm çdo sulmi të mëtejshëm ndaj interesave dhe sigurisë së tij, duke thënë se epoka e "përgjigjeve proporcionale" ka marrë fund.

Duke folur gjatë një seance të hapur parlamentare më 6 shtator, Galibaf tha: "Çdo agresion ndaj interesave dhe sigurisë së Iranit do të marrë një përgjigje më të shpejtë, më të fuqishme dhe më të dhimbshme".

Galibaf foli një ditë pasi ushtria amerikane tha se kishte goditur dhe shkatërruar tri cisterna iraniane të naftës pranë ishujve Harg dhe Jask, si dhe në Gjirin e Omanit.



LEXO EDHE:

'Supreme apo ekstreme', Trump propozon ndryshimin e emrit të inteligjencës artificiale

Komanda Qendrore e ushtrisë së SHBA-së (CENTCOM) tha se sulmet erdhën si përgjigje ndaj sulmeve me raketa balistike të Gardës Revolucionare Islamike (IRGC) ndaj dy anijeve luftarake amerikane, sulme nga të cilat nuk pati viktima amerikane.

Komandanti i CENTCOM-it, Brad Cooper, paralajmëroi se sulmet e vazhdueshme iraniane ndaj anijeve amerikane do të përballen me kosto më të mëdha ekonomike dhe shkatërrimin e cisternave iraniane të naftës.

Ministria e Jashtme e Iranit i dënoi sulmet amerikane si "të paligjshme dhe agresive", ndërsa një



zedënës i shtabit qendror Khatam al-Anbiya – komanda qendrore ushtarake e Iranit – paraqajmeroi se sulmet ndaj ushtrisë amerikane mund të intensifikohen dhe zgjerohen nëse vazhdon bllokada detare.

Më herët gjatë 6 shtatorit, IRGC-ja pretendoi se sulmoi një dron detar amerikane që po përpiquej të hynte në Ngushticën e Hormuzit.

Ngushtica e Hormuzit është rrugë kyç për dërgesat detare pasi para se të niste lufta në fund të shkurtit, nëpër këtë rrugë ujore kalonte rreth një e pesta e dërgesave botërore të naftës dhe gazit./REL

R.Xh/Shqiptarja.com

TAG: [Iran](#) [lufta në Iran](#) [SHBA](#) [Mohammad Baqer Galibaf](#)

Sa e vlerësoni këtë artikull? ★ ★ ★ ★ ★ 5.0 / 5 (3 vlerësime)

LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komente



Ndalohet repretësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH

Sondazhi i ditës:

16 Shtator, 14:18

Haga dënon me 81 vite burg 4 ish-krerët e UÇK-së, si e vlerësoni?

Të drejtë

Të gabuar

Nuk e di

Lajme të tjera



Nga emigracioni të bllokimi i armëve bërthamore të Iranit, Trump publikon 25 'arritjet' e mandatit të tretë

19 Shtator, 21:11



Teherani: Katari i ka përcjellë SHBA-së kushtet tona për t'i dhënë fund luftës

19 Shtator, 18:26



Rebelët Huthi mesazh Italisë: Nuk jemi në luftë me ju, por aeroplanët tuaj janë atje! Shpërthime në aeroportin e Riadit

19 Shtator, 17:19



Berisha: Në SHBA denoncuam aferat e Ramës! Nuk lloboj për t'ia ndaluar vizën në Amerikë, por jam i motivuar ta largoj

19 Shtator, 15:02



Rama nisjet drejt SHBA-së për Asamblenë e OKB-së, më 25 shtator mban fjalim! Takim edhe me komunitetin shqiptar

19 Shtator, 13:16



VIDEOLAJM/ Piloti amerikan 'vizaton' Mona Lizën, fluturon për gati 4 orë për të krijuar portretin gjigant

19 Shtator, 09:41



Trump njofton marrëveshjen për Groenlandën: Do të kontrollojmë sigurinë e saj! SHBA siguron të drejta të përhershme ushtarake në ishull



Massimo Basile



Dosja për UFO-t/ Pentagoni publikon grupin e gjashtë të dokumentave, objekte misterioze të shndritshme shihen duke fluturuar (FOTOT+VIDEO)

18 Shtator, 22:43



SHBA/ Trump 'luftë' me mediat, ndalon CNN, Msnw dhe Politico për të hyrë në Shtëpinë e Bardhë: Përhapi lajme të rreme

18 Shtator, 22:25

19 Shtator, 08:01



Konflikti/ Trump: Jam në një moment vendimtar për Iranin, dua ta asgjësoj! Por Teherani dhe Huthët duan marrëveshje me SHBA

18 Shtator, 19:47



Para zgjedhjeve të mesmandatit, Trump përsërit premtimin: 5 mijë dollarë për çdo amerikan! Brenda republikanëve shtohen rezervat

18 Shtator, 17:04



OKB pretendon se SHBA-ja ka kryer krime lufte në Iran, Shtëpia e Bardhë hedh poshtë raportin

18 Shtator, 15:20

[Kodi Etik](#)

[Kontakt](#)

[Rreth Nesh](#)

[Raportoni Ju](#)

[Puno me ne](#)

[Shqiptarja.com]

Kërko



© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohej riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.